



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 303, Datë 25.11.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË
E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “f”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1993/1prot., datë 22.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 276, datë 27.10.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2022 dhe 29.10.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 06.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1840/1 prot., datë 03.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1840/2 prot., datë 10.11.2022 dhe nr. 1840/4 prot., datë 17.11.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar të gjithë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 2.7, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Kontrata e qirasë për zyrat në shërbim të aktivitetit të furnizuesit është aktualisht e vlefshme, por nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ndaj shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar, jo më vonë se data e fundit e përfundimit të saj, brenda datës 30.09.2027.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë, jo më vonë se data e fundit e përfundimit të saj (brenda datës 30.09.2027).
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI